



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:249409

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06889945

C-IV.-14-5571

I K nga fshati M, Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat B I nga Prishtina.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Ingeniering”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrije Shala, më datë 13.02.2025, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN129-0057 i datës 27 maj 2014.

2.OBLIGOHET e paditura AKP t’i paguaj ankuesit I K në emër të kompensimit për paga të pa paguara për periudhën nga data janar 2007 - dhjetor 2008, shumën prej **5,443.68 €**, ndërsa, në emër të kamatës ligjore prej 10% të kërkesës bazë të kërkuar, shumën prej **544.36 €**.

3.Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

4.OBLIGOHET e paditura AKP, që përfaqësuesit të ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë në shumën prej **208 €**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 13 qershor 2014, ankuesi punëtor i NSH “Ingeniering”, përmes të autorizuarit të ti, avokatit B I nga Prishtina, ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”), kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr.PRN129-0057 i datës 27 maj 2014, me të cilin vendim i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 5,443.68 euro, për periudhën Janar 2007 – Dhjetor 2008, me arsyetimin se të njëjtat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, në bazë të të cilit i njëjti është dashur të kërkojë pagën në afatin prej 3 vjeçare. Ankesa është paraqitur për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të procedurës. Ankuesi me qëllim të vërtetimit të pretendimeve si në ankesë, ka bashkangjitur provat dhe atë: Prokurën për përfaqësim me numër LRP.Nr.3678/2014 e datës 02 qershor 2014, Vendimin e kundërshtuar të AL-së, Listën e punëtorëve për 3 pagat bruto, Librezën e punës ne emrin e tij.

Më datë 21 prill 2020 i autorizuari i ankuesit, në gjykatë ka deponuar një parashtresë përmes të cilës ka bërë precizimin e padisë me që rast ka kërkuar që në emër të pagave të pa paguara paditësit ti kompensohet shuma prej 5,661.72 euro, si dhe për 3 pagat prioritet shumën prej 1,287.00 euro. Me të njëjtën parashtresë ka deponuar edhe provat si: Lista e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2006, Njoftimi për ndërprerjen e marrdhënjes së punës i datës 14 janar 2009, Dokumenti për rikapitulimin e pagave për vitin 2006 me numër 80046723, Vendimin me numër PRN129-0056 i datës 08 maj 2014.

Me datë 03 shkurt 2021 i autorizuari i ankuesit në gjykatë ka deponuar parashtresën me të cilën ka bërë përsëri precizimin e padisë me të cilën ka theksuar se me qene se DHPGJSK, ka bërë ndarjen e padive individuale dhe kolektive dhe me qene se i njëjti me parashtresën paraprake ka bërë kërkesë edhe për kompensimin e tri pagave prioritet me këtë parashtresë e tërheq të njëjtën duke e lënë për objekt shqyrtimi vetëm vendimin PRN129-0057, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara dhe ka kërkuar që për të njëjtat të prishet vendimi i AL-së dhe ankuesit ti nihet e drejta e kompensimit në shumë prej 5,443.68 euro e gjitha me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 104 euro, për rregullim dhe plotësim të padisë shumën prej 104 euro si dhe kompensimin për pagimin e taksës gjyqësore në shumë prej 20 euro. Me që rast si provë ka deponuar Vërtetimin e datës 31 dhjetor 2008.

E paditura ka paraqitur mbrojtjen e saj me datë 11 gusht 2023, me të cilën ka mbetur prapa vendimit të AL-së me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara, duke vlerësuar se kjo e drejtë është parashkruar dhe se i njëjti vendim është i bazuar në ligj dhe se me rastin e vendosjes nuk është shkelur ndonjë dispozitë materiale apo procedurale. Duke shtuar se ankuesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL me rastin e lëshimit të vendimit.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet në tërësi si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit” .

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Injenering”. Nuk është kontestues as fakti se NSH-ja i ka mbetur paga borxh ankuesit. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në provat si: prokurën e përfaqësim me numër LRP.Nr.3678/2014 e datës 02 qershor 2014, vendimin e kundërshtuar të AL-së, listën e punëtorëve për 3 pagat bruto, Librezën e punës ne emrin e tij, Lista e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2006, Njoftimi për ndërprerjen e marrdhënjës së punës i datës 14 janar 2009, Dokumenti për rikapitulimin e pagave për vitin 2006 me numër 80046723, Vendimin me numër PRN129-0056 i datës 08 maj 2014, Vërtetimin e datës 31 dhjetor 2008.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike i administroj të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku, duke i pranuar të njejtat si relevante dhe

bindëse e në bazë të të cilave arriti në përfundimin se ankuesit i takon e drejta në kompensimin e shumës për pagat e mbetura borxh nga NSH-ja, gjë që vërtetohet me vërtetimin e datës 31 dhjetor 2008 e me të cilin mbulohet shuma e kërkuar nga ana e ankuesit e të cilën ankuesi e ka paraqitur si provë.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës lidhur me pretendimin se ka arriturr afati i parashkrimit e të drejtës së kërkesës për kompensimin e pagave, mirëpo pretendimi i tillë nuk është i saktë, pasi në parashkrim nuk përfshihet periudha janar 2007-dhjetor 2008, e për të cilën periudhë edhe i është njohur e drejta e kompensimit, duke u mbështetur në faktin se shuma e kërkuar për kompensim për paga të mbetura borxh arrihet në bazë të vërtetimit të datës 31 dhjetor 2008.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi I K, kishte ofruar shërbime punë për NSH-në dhe se e njëjta i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon edhe shumën në lartësi prej 544.36 euro në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme pala e pasuksesshme urdhërohet të t'i paguajë shpenzimet ashtu siç përcaktohen me Aktgjykimin e formës së prerë. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore me datë 31 korrik 2023.

Ankuesit gjykata ja njohu shpenzimet për përpilimin e padisë në shumë prej **104 euro**, për parashtrësë dhe plotësim të padisë shumën prej **104 €** si dhe shpenzimet për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej **20 euro**,

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrije Shala